



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 161

Tiranë – E shtunë, 30 nëntor 2019

PËRMBAJTJA

	Faqe
Akt normativ i Këshillit të Ministrave nr. 4, datë 30.11.2019	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar..... 12897
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 751, datë 29.11.2019	Për disa shtesa në vendimin nr. 750, datë 27.11.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranë”..... 12897
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 755, datë 30.11.2019	Për një shtesë në vendimin nr. 903, datë 21.12.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë”, të ndryshuar..... 12897



AKT NORMATIV
Nr. 4, datë 30.11.2019

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË LIGJIN NR. 92/2014, “PËR TATIMIN
MBI VLERËN E SHTUAR NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në ligjin nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 56, “Përjashtime të veçanta në import”, bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

1. Në fund të pikës 28 shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“... përjashtuar materialet dhe pajisjet e importuara për këtë qëllim nga organe shtetërore për rastet e shpalljes së “gjendjes së fatkeqësisë natyrore” brenda afatit të përcaktuar.”.

2. Pas pikës 42 shtohet pika 43, me këtë përmbajtje:

“43. Mallrat dhe pajisjet për qëllime ushtarake dhe që përdoren si armë, municion apo bazë materiale luftarake dhe të cilat janë projektuar, zhvilluar, prodhuar, montuar apo modifikuar për përdorim ushtarak, që importohen në emër të Ministrisë së Mbrojtjes.”.

Neni 2

Fjalía e dytë, e pikës 2, të nenit 77, shfuqizohet.

Neni 3

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 751, datë 29.11.2019

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN
NR. 750, DATË 27.11.2019, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR SHPALLJEN E
GJENDJES SË FATKEQËSISË
NATYRORE NË QARQET DURRËS
DHE TIRANË”

Në mbështetje të neneve 100, 170 e 174 të Kushtetutës dhe të neneve 18, shkronja “ç”, 19 e 39, të ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.750, datë 27.11.2019, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa:

1. Në titullin e vendimit dhe në pikën 1, pas fjalës “... Durrës ...” shtohet fjala “... Lezhë ...”.

2. Në fund të pikës 3 shtohet nënparagrafi me këtë përmbajtje:

“Kryetari i Bashkisë Tiranë, me kërkesën e tij.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 755, datë 30.11.2019

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN
NR. 903, DATË 21.12.2016, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN
E KRITEREVE PËR PËRFITIMIN E
BURSAVE NGA FONDI I MBËSHTETJES
STUDENTORE PËR STUDENTËT E
SHKËLQYER, STUDENTËT QË
STUDIOJNË NË PROGRAME STUDIMI
NË FUSHAT PRIORITARE DHE
STUDENTËT NË NEVOJË”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 4 e 112, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të neneve 1 e 5, të ligjit nr. 10289, datë 17.6.2010,



“Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës”, të nenit 2, të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994, “Për statusin e invalidëve të punës”, të ndryshuar, të nenit 6, të ligjit nr. 8153, datë 31.10.1996, “Për statusin e jetimit”, të ndryshuar, të nenit 8, të ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996, “Për statusin e të verbrit”, të ndryshuar, të nenit 8, të ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, të nenit 12, të ligjit nr. 7748, datë 29.7.1993, “Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 14, të vendimit nr. 903, datë 21.12.2016, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 14.1, me këtë përmbajtje:

“14.1 Vetëm për vitin akademik 2019–2020 përfitojnë bursë në masën 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj, studentët të cilët ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë dhe janë anëtarë të familjeve që kanë humbur persona ose që janë shpallur të zhdukur në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë, për shkak të tërmetit të datës 26.11.2019. Institucionet publike të arsimit të lartë identifikojnë studentët dhe dërgojnë listat e studentëve të identifikuar për miratim në ministrinë përgjegjëse për arsimin.”.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2019

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 56 lekë